


REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PROPOZIM

**RREGULLORE
MBI TAKSËN ADMINISTRATIVE PËR LEJE NDËRTIMORE, LEJE RRËNIMI DHE
TARIFËN PËR RREGULLIMIN E INFRASTRUKTURËS**

Lipjan, 2021



Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/ L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari Komunës propozon :

Në bazë të neneve 11, 12 par.12.2 shkronja c), 16 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 17 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27 e datës 03.06.08 nenit 22 dhe 23 të Ligjit nr. 04/L-110 për Ndërtim, Udhëzimit Administrativ MMPh Nr.02/2018 për Taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënim i tarifat përrregullimin e infrastrukturës neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008 në pajtim edhe me Shkresën e Ministrisë së Ekonomisë dhe ambientit përdhënien e pëlgimit për Taksat e e lejes ndërtimore Nr.251/21 e datës 03.02.2021, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e datës 2021, miratoi këtë :

PROPOZIM

RREGULLORE MBI TAKSËN ADMINISTRATIVE PËR LEJE NDËRTIMORE, LEJE RRËNIMI DHE TARIFËN PËR RREGULLIMIN E INFRASTRUKTURËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i miratimit të Rregullores për tarifat ndërtimore (në vazhdim të tekstit: Rregullore) është që Komuna të krijoj burime të të hyrave vjetanake buxhetore në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal.

Neni 2

Objekti i rregullimit

Në bazë të kësaj Rregulloreje përcaktohen taksat dhe tarifat, obliguesit, procedura e pagesave dhe mënyra e llogaritjes për:

2.1 Taksën administrative për Leje ndërtimore

2.2 Taksën administrative për Leje rrënim

2.3 Tarifa e ndikimit në infrastrukturë dhe

2.4 Tarifat rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës

Neni 3

Fushëveprimi

Taksat dhe Tarifat e përcaktuara me këtë Rregullore i zbaton Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.



Neni 4
Obliguesit

Obligues tē pagesës tē tarifave tē përcaktuara me këtë Rregullore janë personat fizik dhe juridik kërkesat e tē cilëve miratohen pér leje ndërtimore.

II. TAKSA ADMINISTRATIVE PËR LEJE NDËRTIMORE

Neni 5
Taksa administrative pér leje ndërtimore

5.1.Taksa administrative pér Leje ndërtimore eshte është buxheti i planifikuar i organeve kompetente komunale pér shqyrtimin e aplikacionit pér leje ndërtimore, procesin e inspektimit, certifikatën e përdorimit si dhe zhvillimi dhe azhurimi i dokumenteve të planifikimit hapësinor, duke perpjestuar koston totale që ndërlidhet me dhënien e Lejes ndërtimore me numrin total te metrave katror tē lejeve tē lëshuara pér vitin paraprak.

5.2 Llogaritja e taksës nga paragrafi 5.1. i këtij neni, bëhet në sipërfaqe (m^2) bruto tē objektit, sipas dokumentacionit ndërtimor – projektit kryesor tē prezantuar, pér tē cilin është dhënë miratimi dhe lejohet ndërtimi.

5.3.Llogaritja e taksës nga paragrafi i kësaj pike, bëhet me Konkluzion, tē lëshuar nga DPUMM.

5.4.Taksa administrative pér leje ndertimi pér Kategorinë e I-rë tē ndërtimit, është $1.50\text{€}/m^2$,

5.5.Taksa administrative pér leje ndertimi pér Kategorinë e II-të tē ndërtimit, është $3.00\text{€}/m^2$,

5.6. Përashtim nga paragrafi 5.2., nga sipërsaqja bruto hiqet shtresa e termoizolimit.

5.7.Baza dhe mënyra e llogaritjes së lartësisë së taksës, si në paragrafit 1 dhe 2 tē kësaj pike, është dhënë në tabelën e shpenzimeve pér leje tē ndërtimit dhe shpenzimet pér kalkulimin e tarifave rregullative pér rrithjen e dendësisë së infrastrukturës, tē cilat janë pjesë përbërëse tē këtij Vendimi.

5.7.Taksa administrative pér leje ndërtimore pér punët ndërtimore që nuk maten me metër katror ose që përbajnë pjesë që nuk mund tē maten me metër katror ose që kanë karakter tē veçantë, përcaktohen duke shumëzuar vlerën investive tē ndërtimit me tarifen e përqindjes së vlerës së investimit, sipas shprehjes:

Për projekte me vlerë investive : $<2\text{million euro } 0.005 \times X + 2300\text{€}$

Për projekte me vlerë investive : $>2\text{million euro } 0.0008 \times X+20000$

Vlera e projektit X tarifa e përqindjes së vlerës = taksa administrative pér leje ndërtimore

5.8. Për punë ndërtimore që nuk maten me metër katror ose që përbajnë pjesë që nuk mund tē maten me metër katror ose që kanë karakter te veçantë, do tē zbatohen taksat e publikuara që përcaktohen nga MMPH.

5.9.Rrjedhja e afatit pér pagesën e taksës, sipas këtij vendimi, fillon ditën e parë pas marrjes në dorëzim tē Konkluzionit pér llogaritjen e taksës përkatëse, dhe ky afat nuk mund tē jetë më i gjatë se 15 ditë.



5.10. Leja e ndërtimit nuk mund të jepet në dorëzim pa provën mbi pagesën e kompensimit të llogaritur.

III. TAKSA ADMINISTRATIVE PËR LEJE RRËNIMI

Neni 6

Taksa administrative për leje rrënimi

6.1 Taksa administrative për Leje rrënimi eshte është buxheti i planifikuar i organeve kompetente komunale për shqyrtimin e aplikacionit për leje rrënimi dhe procesi i inspektimit.

6.2 Llogarijtja e taksës nga paragrafi 5.1. i këtij nenit, bëhet në sipërfaqe (m^2) bruto të objektit, sipas dokumentacionit ndërtimor të prezantuar, për të cilin është dhënë miratimi dhe lejohet rrënimi.

6.3 Llogarijtja e taksës nga paragrafi i kësaj pike, bëhet me Konkluzion, të lëshuar nga DPUMM.

6.4 Taksa administrative për leje rrënimi është $0.50 \text{ €}/m^2$,

6.5 Baza dhe mënyra e llogaritjes së lartësisë së taksës, si në paragrafit 1 dhe 2 të kësaj pike, është dhënë në tabelën e shpenzimeve për leje të ndërtimit dhe shpenzimet për kalkulimin e tarifave rregullative për rritjen e dendësisë së infrastrukturës, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij Vendimi.

6.6 Rrjedhja e afatit për pagesën e taksës, sipas këtij vendimi, fillon ditën e parë pas marrjes në dorëzim të Konkluzionit për llogariljen e taksës përkatëse, dhe ky afat nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë.

IV. TARIFAT

Neni 7

Tarifa rregullative me ndikim të drejtëpërdrejtë në infrastrukturë

7.1 Kjo tarife do të aplikohet pas kërkesës të aplikuesit për leje ndërtimore, në rastet kur Komuna dhe aplikuesi lidhin Marrëveshje zhvillimore për infrastrukturë në tokën ku do të ndërtohet objekti për të cilin kërkohet leja ndërtimore, sipas së cilës Komuna obligohet për ndërtimin e infrastrukturës.

7.2 Aplikuesi për leje ndërtimore konform paragrafit paraprak, duhet të paguaj tarifen rregullative me ndikim të drejtëpërdrejtë në infrastrukturë në lartësinë e kostos së shpenzimeve të Komunës për ndërtimin e infrastrukturës.

Neni 8

Tarifat rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës

8.1 Tarifa për ndikim nga rritja e dendësitetit të infrastrukturës, përcaktohet në bazë të buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin aktual, përkatesisht të shumës së përgjithshme që pritet të shpenzohet për arsim, shërbime publike, mbrojtje dhe shpëtim, shëndetësi dhe mireqenie sociale, arsim, kulturë, rini dhe sport.

8.2 Lartësia e tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës për njësitë e reja të banimit, për ndërtimet e kategorisë I dhe II do të jetë 173.00 €.

8.3 Llogaritja e tarifës nga paragrafi 6.1, bëhet në sipërfaqe (m^2) neto të njësive të reja të banimit, e cila përcaktohet si vijon:

- a. $Sn = \Sigma (S.h. \times k)$, ku:
- b. Sn - Sipërfaqja neto e banesës;
- c. $S.h.$ - sipërfaqja e hapësirës përkatëse në banesë;
- d. k - koeficient.

8.4 Koeficienti "k" për sipërfaqet e ndryshme në banesë ka vlerë të ndryshme, si vijon: të gjitha hapësirat prej hyrjes kryesore në banesë apo në shtëpi individuale të banimit, në shërbim të tyre, duke mos llogaritur sipërfaqen që zënë muret, kanë koeficient $k=1$,

- a. ballkonet $k=0,5$,
- b. loxhat $k=0,75$,
- c. tarracat e mbuluara $k=0,5$,
- d. tarracat e pambuluara $k=0,25$,
- e. depo jashtë banesës $k=0,5$.

8.5 Meqë nuk krijojnë dendësi, nga tarifa për ndikimin e densitetit të infrastrukturës përashtohen:

- a. lokalet afariste,
- b. hapësirat e përbashkëta në ndërtesat e banimit në bashkëpronësi si: para hyrjet, ashensorët, shkallët, shkallet kundër zjarrit, korridoret, kthinan teknike, depot, hapësirat për këshillin shtëpiak, bodrumet, garazhet etj;
- c. hapësirat ajrore në kuadër të objektit;
- d. pasazhet;
- e. kulmet e pashfrytëzuara;
- f. tarracat në bashkëpronësi dhe para lokaleve; dhe
- g. kthinan tjera të ngjashme që nuk konsiderohen hapësira për banim.

8.6 Këtë tarifë e aplikon dhe e përcakton Drejtoreti për planifikim, urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, sipas formulës në vijim:

Metrat katror të objektit të banimit për të cilin lëshohet leja ndërtimore pjesëtohen me numrin 50 (sipërfaqe e supozuar për një banues) dhe shumëzohen me vlerën e shpenzimeve të pritura për shërbime arsimore, shëndetësore, kulturë, rini dhe sport për kokë banori sipas Buxhetit të vitit aktual.

Neni 9

Lirim nga taksat dhe tarifat

9.1 Nga lartësia e taksës dhe tarifave të përshtikuara në nenet 5, 6, 7 dhe 8 do të lirohen kategoritë si vijon: objektet e interesit publik të ndërtuara nga investimet kapitale të Komunës dhe niveli qendror, objektet e interesit publik që financohen permes donacioneve dhe granteve, ndërtimet për banim individual për nevojat e zgjidhjes së çështjes së banimit të rasteve sociale me investime në bazë të donacioneve, familjeve të ngushta të dëshmorëve, invalidëve të luftës, veteranet e luftës, ish të burgosurit politik dhe familjet e ngushta të tyre, personat me aftësi te kufizuara, objektet për përfaqësuesit

diplomatikë ku investuese janë shtetet e huaja, investimet publiko-private dhe objektet me destinim selar.

9.2 Për lirimet nga tarifat e përcaktuara sipas paragrafit 9.1, duhet të prezantohen vërtetime nga institucionet përkatëse.

V. PROCEDURA E ANKESAVE

Neni 10 Kërkesa për rishqyrtim dhe ankesa

Obliguesi, i pakënaqur me lartësinë e caktuar të tarifës sipas kësaj Rregulloreje, mund të parashtrojë kërkesë për rishqyrtim ose ankesë në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.

VI. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 11 Hyrja në fuqi

11.1. Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Websaqen e Komunës.

11.2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja mbi taksën administrative për leje ndërtimore, leje rrënimisë dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës 15Nr.011-6214 e datës 31.01.2020.

Arsyetimi

Baza ligjore për miratimin e kësaj Propozim-Rregulloreje është e përcaktuar me dispozitat e nenit 11, 12 par.12.2 shkronja c), 16 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershori 2008, nenit 17 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27 e datës 03.06.08 nenit 22 dhe 23 të Ligjit nr. 04/L-110 për Ndërtimin, Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.02/2018 për Taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënimisë dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008 në pajtim edhe me Shkresën e Ministrisë së Ekonomisë dhe ambientit për dhënien e pëlgimit për Taksat e lejes ndërtimore Nr.251/21 e datës 03.02.2021

Dispozita e nenit 17 e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049 thekson:

17.1 Përmes një rregulloreje, komuna mund të vendosë tarifa të cilat caktohen me qëllim tëkompensimit të shpenzimeve të komunës për ndërtimin, përmirësimin, zgjerimin ose riparimin e infrastrukturës komunale, nëse këto masa bëhen të nevojshme si pasojë e drejtpërdrejtë e (i) ndërtimit të ndërtesave të reja ose (ii) zgjerimit ose rehabilitimit të konsiderueshëm të ndërtesave ekzistuese.

17.2 Nëse ndërtimi, zgjerimi ose rehabilitimi i sipërpermendur shkakton rritjen e numrit të njësive banuese në komunë, komuna mundet, përmes një rregulloreje, të vendosë tarifa të

cilat duhet të paguhen për shkak të ndikimit që ka kjo rritje e popullsisë në shërbimet arsimore, shëndetësore dhe shërbimet e tjera të cilat ofrohen nga komuna.

Bazuar ne Udhezimin Administrativ të MMPH Nr.02/2018 jane definuar Jane përcaktuar taksat dhe tarifat, obliguesit, procedura e pagesave dhe mënyra e llogaritjes për:

- Taksën administrative për Leje ndërtimore
- Taksën administrative për Leje rrënimë
- Tarifat irregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës

Taksat e propozuara me kete Rregullore janë përcaktuar sipas Metodologjisë për llogaritjen e taksës për Leje Ndërtimi per kategorinë e I-rë, dhe të II-të, Taksës administrative për Leje rrënimë dhe tarifat irregullative për rritjen e densitetit te infrastrukturës – e cila eshte e paraparë në Shtojcën e Udhezimit Administrativ Nr.02/2018.

Tarifa irregullative me ndikim te drejtëpërdrojtë në infrastrukturë e përcaktuar në nenin 5 propozohet konform nenit 17 par.1 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 9 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor mbi taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës.

Sipas dispozitës së nenit 9 par.2 të Udhëzimit të lartëcekur, organi kompetent mundet pas aplikimit për leje ndërtimore të një personi që ka interes juridik në tokë ndërtimore, të hyjë në një marrëveshje me atë person për sa i përketë zhvillimit të asaj toke.

Taksa administrative për leje ndërtimore për punët ndërtimore që nuk maten me metër katror ose që përbajnjë pjesë që nuk mund të malen me metër katror ose që kanë karakter të veçantë, përcaktohen duke shumëzuar vlerën investive të ndërtimit me tarifën e përqindjes së vlerës së investimit, sipas shprehjes:

Vlera e projektit X tarifa e përqindjes së vlerës = taksa administrative për leje ndërtimore. Për punë ndërtimore që nuk maten me metër katror ose që përbajnjë pjesë që nuk mund të maten me metër katror ose që kanë karakter te veçantë, do të zbatohen taksat e publikuara që janë përcaktuar nga MMPH.

Per projektet me vlore investive deri ne 2 milion euro eshte $0.005 \times X + 2300\text{€}$ ku X eshte vlera investive e projektit.

Per projektet me vlore investive mbi 2 milion euro eshte $0.0008 \times X + 20000\text{€}$ ku X eshte vlera investive e projektit.

Bazuar në dispozitat e nenit 14 të Udhëzimit Administrativ nr.22/2018 të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor mbi taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës:

Komuna duhet të publikojë taksat dhe tarifat dhe gjatë kësaj periode Komuna duhet të inkurajoj dhe të lejoj komentet publike për propozimin e ndryshimeve si përmes portalit ashtu edhe përmes dorëzimit të shkresave për Departamentin e urbanizmit.

Tarifat bëhen të plotëfuqishme më së largu 30 ditë pas përfundimit të periudhës për komente dhe miratimit nga Kuvendi i Komunës.

Për të vepruar konform dispozitës së lartëcekur, është hartuar kjo Projekt Rregullore e veçantë për taksat administrative dhe tarifat ndërtimore.

Kjo Propozim Rregullore në pajtim me dispozitat ligjore ka qenë në shqyrtim publik si dhe është marrë Pëlqimi paraprak edhe nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit me shkresën Nr.251/21 e datës 03.02.2021.

Nga të cekurat më lartë kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e kësaj Propozim Rregulloreje.

1Nr. 011 - 12150

Lipjan, më 03-03-2021

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine
Ministry of Economy and Environment

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalpog Sekretara/Office of Generaly Secretary

DATË/AI:	29/01/2021
REFERENCA:	
PËRSZATOR:	Emissa Rexhiq-Drejtoria për Planifikim Urban (DPL) Mbeyllje (ë Mjedisi) Komuna Lipjanit
CC:	
NGA/QD/PRON:	Faqet Qerimi, Selitëria e Përgjithshëmi i MBPASHR
TEMA/SUBJEKAT/SUBJEKT:	Shqyrimi i shkresës së Komuna e Lipjanit me numër të protokollit nr.251/21 të datës 21/01/2021 për dhënien e pëlgimit për Taksat e lejes ndërtimore

Tënderuar,

Bazuar në shkresën e datës 21/01/2021 me numër protokoll 251/21, lidhur me caktimin e taksës administrative për leje ndërtimore, taksës administrative për leje rrënimë, dhe tarifës për rrjetjen e densitet të infrastrukturës nga Komuna e Lipjanit (tutje si: Komuna), MEA ka shqyrtuar dhe analizuar shkresën se bashku me dokumentacionin përcjellës dhe konstaton si në vijim:

Komuna ka propozuar Taksat në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënimë, dhe tarifat përmirëguar për infrastrukturës.

Taksa Administrative për leje ndërtimore për kategorinë e I-rë është 1,50 €/m² (një euro e pesëdhjetë centë për metër katror).

Taksa Administrative për leje rrënimë është 3,00 €/m² (tri euro për metër katror).

Taksa Administrative për leje rrënimë e llogaritur nga Komuna për kategorinë I dhe II është 0,50 €/m² (zero euro e pesëdhjetë centë për metër katror).

Tarifa për rrjetjen e densitetit të infrastrukturës është llogaritur konform Shtojcës 7 të UA Nr.02/2018 dhe kjo Tarife duhet të llogaritet vetëm për njësit e reja të banimit.

Komuna duhet të procedoj për aprosim taksat në pajtim me procedurat e parapara me Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110.

Me respekt,

Faqe 1 nga 1